



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV
Themelimi i institucioneve arsimore

NUMËR:9/2008
DATË: 26.5.2008

Në bazë të nenit 1.3 pikës d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 4.3 , 11.2, 11.3 të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë si dhe nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

Neni 1
Qëllimi

Me këtë UA përcaktohen kushtet dhe procedurat e themelimit të institucioneve arsimore (institucioneve parashkollore, shkollave fillore,shkollave të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta) dhe themelimin e paraleles së ndarë fizike (në tekstin e mëtejme shkolla).

Neni 2

Themeluesi

Themelimin e shkollës dhe të paraleles së ndarë fizike e bën Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë.

Neni 3

Kërkesa

DKA-ja i`a bën kërkesën me elaborat themeluesit për themelimin e shkollës, respektivisht Departamentit për Administratën e Arsimit Parauniversitar në MASHT.

Neni 4

Kushtet

Një shkollë mund të themelohet nëse i plotëson këto kushte:

1. Numri i mjaftueshëm i nxënësve- fëmijëve,
2. Kuadri i kualifikuar arsimor për nivelin dhe drejtimin përkatës,
3. Objekti shkollor me lokalet përcjellëse,
4. Lista kadastrale për pronësinë e truallit,
5. Projekti dhe leja për ndërtimin e objektit shkollor,
6. Mjetet financiare të siguruara për zhvillimin e veprimtarisë edukativo arsimore.

Neni 5

Verifikimi i kushteve

Verifikimin e kushteve për zhvillimin e veprimtarisë edukativo- arsimore në bazë të Elaboratit, e bën Departamenti i Administratës Arsimore në MASHT.

Neni 6

Vendimi

Pas verifikimit të kushteve për zhvillimin e punës edukativo- arsimore në shkollë, MASHT merr vendim për themelim.

Neni 7

Përmbajtja

Vendimi për themelim përmban:

1. Emrin e themeluesit,
2. Komunën dhe selinë e shkollës,
3. Tipin e shkollës,
4. Nivelin e veprimtarisë edukativo- arsimore.

Neni 8

Themelimi i paraleles së ndarë fizike

Themelimi i paraleles së ndarë fizike bëhet me procedurë të njëjtë, sipas nenit 4, për themelimin e shkollës.

Neni 9

Vendimi për themelimin e paraleles së ndarë

Vendimi për themelimin e paraleles së ndarë fizike përmban:

1. Emrin e themeluesit,
2. Emrin dhe selinë e shkollës amë,
3. Selinë e paraleles së ndarë,
4. Nivelin e shkollimit.

Neni 10

Themelimi i paraleles së ndarë në shkollë më vete

Paralelja e ndarë fizike mund të themelohet shkollë më vete, me procedurë të njëjtë, sipas neni 4 të këtij UA.

Neni 11

Komisioni

Për themelimin e paraleles së ndarë në shkollë më vete, formohet Komisioni për ndarjen e kuadrit arsimor, personelit dhe inventarit të shkollës

Neni 12

Përbërja

Komisioni përbëhet prej:

1. Një përfaqësuesi të DKA-së, kryetar,
2. Një përfaqësuesi të shkollës amë, dhe
3. Një përfaqësuesi të shkollës në themelim.

Neni 13

Procesverbali

Komisioni mban procesverbal, dhe nga një ekstrakt të procesverbalit ia dorëzon ish shkollës amë, shkollës në themelim dhe DKA-së.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri.

Enver Hoxhaj, ministër